ATRC punon me përfaqësues të organizatave jo-qeveritare (OJQ-ve), iniciativave qytetare, administratës publike, subjekteve politike dhe mediave palltim feje, përkatësie politike, etnie, aftësie, moshe, gjinie dhe orientimi seksual.

ATRC i realizon qëllimet e veta përmes avokimit, trajnimit, shkëmbimit të informatave dhe rrjetëzimit në dhe jashtë Kosovës.

## Për ATRC-në

Që prej themelimit më 2001, ATRC në Prishtinë ka ndihmuar OJQ-të në Kosovë për të profesionalizuar punën e tyre, artikular kërkesat dhe avokuar tek strukturat qeveritare për çështjet që kanë ndikim në shoqërinë kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes trajnimit, ndarjes së granteve, avokimit, shkëmbimit të informatave dhe asistencës teknike. Programet e ATRC-së janë të dizajnuar për ti plotësuar nevojat e OJQ-ve.

Shërbimet e ATRC-së përfshijnë menaxhim grantesh; trajnime dhe konsulenca bazike dhe të avancuara në fushat kyçe të zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhim, avokim dhe shtim fondesh; resurse elektronike informative përmes ueb-faqes; marketing dhe komunikim; debate publike, krijim të koalicioneve, lehtësim procesi të partneriteteve dhe

bashkëpunimeve ndër-sektoriale.

Për të realizuar misionin, ATRC po ashtu bashkëpunon me OJQ-të në tërë Kosovën për fushata avokimi të fokusuara në zhvillimin demokratik dhe pjesëmarrjen publike, si dhe drejtton qendrën e burimeve dhe bibliotekën me botime për çështjeve të ndryshme sociale, politike dhe ekonomike të Kosovës dhe Ballkanit.

Gjatë tri viteve të para, ATRC ka implementuar Projektin për Avokim të OJQ-ve Kosovare të përkrahur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Gjatë kësaj kohe, ATRC ka bashkëpunuar ngushtë me Institutin për Menaxhim Lindje-Perëndim i cili ka drejtuar projektin, si dhe me Fondacionin për Iniciativa Demokratike, organizatë vendore kjo për menaxhim grantesh. Gjatë këtij projekti, ATRC është përqendruar në trajnime, ngritje kapacitetesh, përkrahje të iniciativave avokuese, dhe shkëmbim informatash për OJQ-të në dhe jashtë Kosovës.

Në mesin e vitit 2005, ATRC është bërë partnere lokale e Bordit për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX) për të përkrahur zhvillimin e OJQ-ve kosovare në kuadër të Programit trevjeçar për Shoqëri Civile (KCSP) të financuar nga USAID. Ndryshimet në program, mundësuan zgjerimin e shërbimeve të ATRC-së për të shtuar efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Që nga korriku 2006, ATRC është partnere e UNHCR-së në implementimin e Projektit për Monitorimin e të Kthyerve në Aeroportin e Prishtinës që ka për qëllim regjistrimin të kthyerve me dhunë dhe vullnetar nga shtetet perëndimore.

Gjatë vitit 2007, ATRC ka ndërmarr iniciativa të reja në mbarë Kosovën duke organizuar takime dhe debate publike për Propozimin e Ahtisarit, procesin e zgjidhjes së statusit, zgjedhjet lokale, etj. Po ashtu ka përgatitur planifikimin strategjik të tri shoqatave lokale joqeveritare: Lidhja e Pensionistëve dhe Invalidëve, Shoqata e Minatorëve Pensionistë dhe Invalidë, dhe Shoqata e Personave të Verbër dhe me të Pamë të Dobësuar.

## Përkrahësit

ATRC varet nga burimet financiare dhe njerëzore të ofruara nga përkrahësit e saj, për të realizuar programe dhe aktivitete të ndryshme.

- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Bordi për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX)
- Zyra Britanike në Prishtinë
- Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
- Fondi i Vellezërve Rockefeller (RBF)
- Akademia për Zhvillim Arsimor (AED)
- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)
- IPKO Instituti (IPKO)

## Partnerët

Në vitin 2007, ATRC është bërë partnere e organizatave dhe institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare kosovare e ndërkombëtare në përpjekje për ti afruar qytetarët me vendim-marrësit. Partnerët kanë ndarë përvojën e tyre dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me ATRC-në në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme.

- Instituti për Studime të Avancuara (GAP)
- Shoqata e Gjykatësve të Kosovës
- Habitat i OKB-së
- Shërbimi Katolik i Ndihmave (CRS)
- Qendra Rajonale Mjedisore (REC)
- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)
- Shoqata e Minatorëve Pensionist dhe Invalid të Kosovës
- Swiss Kontakt
- Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Grave (WSSI)

## Lidhur me këtë raport

Raporti Vjetor 2007 u ofron përkrahësve, partnerëve dhe publikut pasqyrë të punës dhe aktiviteteve të ATRC-së. Raporti pëershkruan aktivitetet prej janarit deri në dhjetor të vitit 2007 në kuadër të katër programeve kryesore të ATRC-së për trajnim konsulencë & ngritje kapacitetesh, informim, menaxhim grantesh, dhe avokim. Informata shtesë për ATRC-së mund të gjeni në: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

# PROGRAMI PËR TRAJNIM, KONSULENCË & NGRITJE KAPACITETESH



**Programi i ATRC-së për Trajnim, Konsulencë dhe Ngritje Kapacetetesh** ka për qëllim t'iu ofroj përfaqësuesve të OJQ-ve metodat që u nevojiten për të ndikuar në ndryshime në komunitetet e tyre. Gjatë gjashtë viteve të fundit, në kuadër të këtij programi janë realizuar trajnime për menaxhim organizativ, avokim, marrëdhënie me media, marketing, planifikim strategjik, menaxhim konflikti, negociata dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me OJQ-të. Pasi që organizatat janë ballafaquar me sfida të reja, ATRC ka dizajnuar trajnime më të avancuara për ti përbushur nevojat e OJQ-ve. ATRC ka shtuar shërbimet e trajnimit për të a) ngritur kapacetetet e OJQ-ve që merren me të rintjtë, shëndetësinë, pensionet, personat më aftësi të kufizuara dhe gratë Rome Ashkali & Egjiptiane, dhe b) për ti trajnuar përfaqësuesit e OJQ-ve dhe zyrtarët komunal për menaxhim të konfliktit dhe negociata.

Në vitin 2007, trajnerët e ATRC-së kanë realizuar 62 trajnime bazike dhe të avancuara në fushat kyçë të zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhim, avokim, dhe shtim fondesh, gjatë të cilave 1278 personave të gjashtë nacionaliteteve u janë ndarë certifikata për pjesëmarrje të suksesshme në trajnime. Trajnimet janë fokusuar në këto tema:

### Shkrimi i projekt propozimit

Në muajin prill, ATRC ka organizuar trajnim dyditor i cili është fokusuar në shpjegimin e përgjithshëm të shkrimit të një projekt propozimi me të gjitha elementet e një propozimi të tillë. Metodologjia e trajnimit është bazuar në qasjen logjike, e cila iu ka mundësuar pjesëmarrësve zhvillimin e projekteve nga idetë fillestare në përcaktimin e objektivave, planeve të zbatimit të projektit, dhe buxhetin.

### Menaxhimi bazik financiar

Përfaqësues të OJQ-ve janë trajnuar për menaxhimin e financave gjatë dy trajnimeve të organzuara nga ATRC në muajin prill dhe qershor. Trajnimet kanë përfshirë komponentë të kontabilitetit, mbajtjes ditore dhe mujore të të dhënave, bashkërendimit bankar, planifikimit dhe buxhetit, politikave dhe procedurave financiare dhe termat e domosdoshëm në financa dhe kontabilitet.

### Avokimi dhe krijimi i koalacioneve

Në muajin prill, qershor dhe nëntor, ATRC ka organizuar trajnime për zhvillimin e shkathtësive avokuese dhe krijim të koalacioneve të nevojshme për punë efektive avokuese. Trajnimet iu mundësuan OJQ-ve lokale ta kuptojnë procesin avokues dhe ndikimin në politikat publike, ti identifikojnë çështjet për të avokuar, të përcaktojnë objektiva të qarta avokuese, të përzgjedhin strategji efektive avokuese, dhe të krijojnë rrjete dhe koalicionë për të pasur më shumë ndikim.

### Qeverisja e mirë

Në muajin maj, ATRC ka trajnuar përfaqësuesit e OJQ-ve lidhur me qeverisjen e mirë. Trajnimeti ka trajtuar konceptet, strukturat dhe parimet e udhëheqjes së OJQ-ve dhe sektorit jofitimprurës. Komponentët e trajnimit përfshinë standartet ndërkombëtare për OJQ-të, rolet e bordit, funksionet dhe përgjegjësitë, llogaridhëni e OJQ-ve, transparencën dhe kodin e etikës, zhvillimin e praktikave të menaxhimit demokratik, dhe sistemet e menaxhimit financiar dhe administrativ.

### Raportet OJQ-media

Përfaqësuesit e OJQ-ve lokale janë trajnuar në maj për relacionet me median. Trajnimeti dy-ditor ka mbuluar raportet dhe perspektivën e rolit të medave dhe OJQ-ve në çështjet që kanë të bëjnë me shoqërinë civile. Qasje të ndryshme të raporteve OJQ-media u janë prezantuar pjesëmarrësve përmes analizimit të palëve me interes, realizimit të mesazheve, organizimit të konferencave, shkrimit të njoftimeve për media, etj.

### Roli i OJQ-ve në shoqërinë civile

Në qershor, ATRC ka realizuar trajnim për strukturat dhe karakteristikat përcaktuese të sektorit të shoqërisë civile dhe OJQ-ve në shoqëritë demokratike në tranzicion. Sesionet e trajnimit janë përqendruar në tiparet dhe marrëdhëniet në mes të shtetit, tregut dhe shoqërisë civile, dhe rolet e ndryshme të OJQ-ve në kontekstin kombëtar dhe global. Pjesëmarrësit po ashtu kanë mësuar se si të hartojnë strategji për të shtuar ndikimin e tyre në zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike.



## Menaxhimi i OJQ-së

Në kuadër të punëtorive trajnuese për vitin 2007, ATRC ka organizuar në korrik trajnim tre-ditor për parimet e menaxhimit dhe zhvillimit organizativ të OJQ-ve. Pjesëmarrësít rishikuan misionet e tyre, zhviluan aftësitë për planifikim strategjik, dhe u njoftuan me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të kapaciteteve brenda OJQ-së.

## Marketingu në OJQ

Në muajin shtator, ATRC ka realizuar trajnim dyditor për OJQ-të, të titulluar "Komunikimi në Marketing". Trajnimini është fokusuar në komunikimin ndërmjet OJQ-ve dhe palëve me interes duke i integruar në mënyra specifike audiencat përkatëse përmes qasjeve të ndryshme dhe mesazheve të duhura.

## Menaxhimi i ciklit të projektit

Në tetor, ATRC ka trajnuar përfaqësuesit e OJQ-ve për komponentët kyç në menaxhimin e projektit përfshirë zhvillimin e idesë, analizën e problemit, shkrimin e projekt propozimit, zbatimin e projektit, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin. Pjesëmarrësve u është prezantuar metodologjia për menaxhim të suksesshëm të projekteve.

## Barazia gjinore

Në muajin tetor dhe nëntor, trembëdhjetë zyrtarë komunash për çështje gjinore dhe njëmbëdhjetë gazetarë janë trajnuar nga ATRC lidhur me barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën familjare. Trajnimet kanë pasur për qëllim a) ngritjen e vetëdijes së gazetarëve dhe përgjegjësisë së tyre në promovimin e imazheve jo stereotipe të grave dhe burrave, dhe b) trajnimin e zyrtarëve komunal përllobim, avokim, shtim fondesh dhe bashkëpunim me palët e tjera në nivel komunal për të bashkëpunuar më ngushtë me OJQ-të e grave.

## Zgjidhja e konfliktit social

Trajnerët e ATRC-së kanë realizuar katërmëdhjetë trajnime për menaxhim të konfliktit në rajonin e Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Ferizajit, Prizrenit, Mitrovicës dhe Gjakovës gjatë muajit mars, prill, maj, qershor dhe shtator. Trajnimet e veçanta për zyrtarë komunal dhe OJQ kanë pasur për qëllim ti ndihmojnë qeverisë lokale dhe shoqërisë civile në forcimin e

marrëdhënieve dhe kontakteve mes tyre me qëllim të reagimit më të mirë ndaj nevojave të komuniteteve të tyre përmes mjeteve dhe teknikave të zgjidhjes së konfliktit.

ATRC ka organizuar shtatë trajnime të tjera për negociata gjatë tectorit, nëntorit dhe dhjetorit dedikuar OJQ-ve dhe autoritetet e komunale të racioneve të Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Mitrovicës, Ferizajt, Prishtinës dhe Prizrenit. Trajnimet bashkuan këta dy sektorë në një grup në secilin rajon të Kosovës dhe u fokusuan në përgatitjen dhe rezultatet e negociatave, negociatat asimetrike, ndërmjetësimin, delegacionin, etj.

## Trajnimet për nën-sektorët e shoqërisë civile

Trajnerët dhe konsulentët e ATRC-së kanë realizuar tetëmbëdhjetë trajnime në vitin 2007 për pesë sektorë të ndryshëm të OJQ-ve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të nën-sektorëve të shoqërisë civile në Kosovë. ATRC ka asistuar në ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve që merren me çështje rimore, shëndetësore, pensionale, me persona me aftësi të kufizuara dhe gratë rome ashkalike & egjiptiane përmes trajnimeve për menaxhim të projektit, qeverisje të mirë, menaxhim bazik financiar, avokim dhe krijim koalicionesh, shkrim të projekt propozimit, rolin e OJQ-ve në shoqërinë civile, monitorin dhe evaluim, avokim dhe rrjetëzim, planifikim strategjik dhe avokim për të krijuar ambient dhe infrastrukturë të përshtatshme për vullnetarizëm.

## Trajnimet për aplikantët për grante të KCSP-së

Në muajin janar dhe shkurt, ekipi trajnues i ATRC-së ka realizuar katër trajnime për "Shkrim të Projekt

Propozimit" për OJQ-të të cilat kanë qenë duke përgatitur aplikacionet për Grantet për Avokim në Nivel Lokal (rundi II) dhe Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim (rundi V) në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile tw IREX-it, të shpallura dhe administruara nga ATRC. Gjatë këtyre trajnimeve interaktive në Prishtinë, Graçanicë dhe pjesën veriore të Mitrovicës, OJQ-të janë trajnuar për shkrimin e projekt propozimeve të tyre.

## Konsultimet individuale

Me qëllim që të sigurohet ndikim më i madh i sektorit të OJQ-ve, ATRC ka ofruar konsultime individuale për organizatat joqeveritare. Përfaqësues të OJQ-ve janë këshilluar enkas për nevojat specifike të organizatave të tyre lidhur me një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me shkrim të projekt propozimit, zhvillim organizativ, menaxhim dhe shtim fondesh. Në vitin 2007, 234 përfaqësues të OJQ-ve kanë përfituar nga konsulencat e ATRC-së.

*Trajnimet dhe konsultimet individuale u janë ofruar falas OJQ-ve të Kosovës të regjistruara si OJQ kiente të ATRC-së, të cilat gjithsej janë 226 OJQ*

## Trajnimet sipas kërkesës

Në vitin 2007, ATRC ka realizuar tri trajnime për avokim dhe krijim koalicionesh, shkrim të projekt propozimit, dhe menaxhim të projektit me kërkesë nga jashtë. Dy trajnime në Kaçanik dhe Pejë u janë dedikuar anëtarëve të Kryqit të Kuq të Kosovës, me kërkesë të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ndërsa, me kërkesë të Komitetit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, ATRC ka trajnuar anëtarët e Shoqatës së Familjeve të Personave të Pagjetur të Kosovës.





## PROGRAMI PËR MENAXHIM GRANTESH



Në vitin 2007, ATRC ka ndarë dhe administruar gjashtëdhjetë grante për OJQ-të lokale në kuadër të IREX Programit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP) të financuar nga USAID. Programi i granteve është ndarë në tri kategori: Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim, Grantet për Avokim në Nivel Lokal dhe Grantet për Aktivitete Jopartiake të Lidhura me Zgjedhjet.

OJQ-të kanë aplikuar për grantet e KCSP-së përmes konkurseve të hapura. Shtatë konkurse janë publikuar në mediume të respektuara të lajmeve, dhe personeli i ATRC-së dhe IREX-it ka organizuar takime informative për OJQ-të e interesuara për të aplikuar për grantet e KCSP-së.

IREX/KCSP GRANT PROGRAMI	NUMRI I GRANTEVE	SHUMA
Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim	26	\$355,024.15
Grantet për Avokim në Nivel Lokal	16	\$71,727.74
Grantet për Aktivitete Jopartiake të Lidhura me Zgjedhjet	18	\$ 113,491.53
TOTALI	60	\$540,243.42



**Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim** janë ndarë përmes rundeve IV, V, VI dhe VII për OJQ-të, projekt-propozimet e të cilave kanë përbajtur komponentë partneriteti dhe rrjetëzimi ndërmjet OJQ-ve, dhe sektorëve të tjera (qeverisë lokale ose qendrore, bizneseve private). Projektet kanë adresuar çështje kyçë lidhur me fushat kryesore të granteve siç janë transparenca dhe anti-korrupsioni, zhvillimi i komunitetit, pajtimi ndëretnik, dhe zgjidhja e konfliktit.

## Partneritet dhe Rrjetëzim Rundi IV

Në muajin shkurt, shtatë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës	Ndalimi i degradimit të vendbanimit Kodra e Diellit në Prishtinë	Prishtinë	\$ 19,049.00
Shoqata e Gjykatësve të Kosovës	Transparenca dhe antikorrupsioni në sistemin gjyqësor të Kosovës	Prishtinë	\$ 24,935.49
Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut	Transparenca dhe e drejta për informim publik mbi dokumentet zyrtare	Prishtinë	\$ 24,930.00
Instituti Demokratik i Kosovës "KDI"	Ngritja e parimeve për qeverisje të mirë	Prishtinë Rahovec Lipjan Obiliq	\$ 24,298.74
Dora Dorës	Qendra informative e grave	Fushë Kosovë	\$ 7,255.00
Këshilli i Grave për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut	Dialogu i komuniteteve lokale në Kosovë, mirëbesimi dhe pajtimi	Obiliq	\$ 20,010.00
Documenta	Fol	Prishtinë	\$ 24,979.92
<b>TOTALI I GRANTEVE PËR PARTNERITET DHE RRJETËZIM, RUNDI IV</b>			<b>\$ 145,458.15</b>

## Partneritet dhe Rrjetëzim Rundi V

Në muajin qershor, shtatë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
HandiKos	Mundësi të njëjta për personat me aftësi të kufizuara	Mitrovicë	\$ 7,740.00
Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim "IRD"	Afrimi i qytetarëve me komunat e tyre	Prishtinë	\$ 17,098.00
Asociacioni për Financa dhe Shërbime të Kontabilitetit "AFAS"	Mbështetje sektorit të OJQ-ve lokale në përgatitjen e deklarimeve financiare	Prishtinë	\$ 24,000.00
Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar "KCIC"	Me transparencë drejtë progresit	Gjilan	\$ 20,788.00
Shoqata për Iniciativa Bashkëkohore	Integrimi dhe ngritja e vetëdijes për komunitetit Boshnjak në Kosovë	Prizren	\$ 16,511.00
Qendra për Zhvillim Social	Qendra për zhvillimin e rinisë	Graçanicë	\$ 19,810.00
Handicap Kosova	Inicimi i implementimit të ligjeve për personat me aftësi të kufizuara	Prishtinë	\$ 13,975.00
<b>TOTALI I GRANTEVE PËR PARTNERITET DHE RRJETËZIM, RUNDI V</b>			<b>\$ 119,324.00</b>

## Partneritet dhe Rrjetëzim Rundi VI

Në muajin shtator, pesë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese "BIRN"	TV emisionet "Jeta në Kosovë"	Prishtinë	\$ 17,980.00
Shoqata e Gjykatësve të Kosovës	Strategjia për sistem gjyqësor transparent dhe jokorruptiv	Prishtinë	\$ 16,729.00
Aksioni për Jo-Dhunë dhe Paqe	Të ndërtojmë ura	Gjilan	\$ 8,940.00
Produksioni New-Press	Të flasim për shoqerinë tonë	Çagllavicë	\$ 14,398.00
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave "KIPRED"	Integriteti i zgjedhjeve në Kosovë	Prishtinë	\$ 49,884.00
TOTALI I GRANTEVE PËR PARTNERITET DHE RRJETËZIM, RUNDI VI			\$ 58,047.00

## Partneritet dhe Rrjetëzim, Rundi VII

Në muajin tetor, shtatë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
Ballkan Sunflowers	Filmat që kanë ndryshuar botën	Prishtinë	\$ 16,500.00
Mileniumi i Ri	Vendim-marrja qytetare	Prishtinë	\$ 11,142.00
Projekti Media Opinion "ProMo"	Qeverisje e përgjegjshme përmes pjesëmarrjes së qytetarëve	Rahovec	\$ 14,610.00
Iniciativa për Progres "INPO"	Për një departament transparent dhe të drejtë të prokurimit në Komunën e Ferizajit	Ferizaj	\$ 8,780.00
Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet "Çohu"	Partneriteti për ngritje të vetëdijes mbi antikorrupsionin	Prishtinë	\$ 16,486.00
Shoqata e Intelektualëve të Pavarur "SHIP"	Strategjia komunale për zhvillimin e bujqësisë	Deçan	\$ 10,580.00
Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara "OON"	Vend përmundësi të barabarta	Gracanica	\$ 13,505.00
TOTALI I GRANTEVE PËR PARTNERITET DHE RRJETËZIM, RUNDI VII			\$ 91,603.00

**Grantet për Avokim në Nivel Lokal** runden II dhe III janë ndarë për OJQ-të, propozimet e të cilave kanë veçuar partneritetin ndërmjet OJQ-ve dhe qeverive lokale, si dhe krijimin e aleancave ndërmjet OJQ-ve dhe grupeve qytetare për të avokuar për shërbime më të mira publike, procese qeveritare më transparente, dhe përmirësuar kushtet e jetesës në nivel komuniteti.

## Avokim në Nivel Lokal, Rundi II

Në muajin mars, tetë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
Agro Eko	Edukimi i qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit, posaçërisht lumi Dobrusha	Gjilan	\$ 5,000.00
Qendra për Këshillime, Hulumtime dhe Trajtime Psikologjike "CCRPT"	Parandalimi i dhunës në shkolla	Ferizaj	\$ 4,798.75
Syri i Vizonit	Planifikimi urbanistik i vendbanimit Zatra në Komunën e Pejës	Pejë	\$ 3,980.00
Jeto Jetën	Qasja e personave me aftësi të kufizuarë në shkollën e Prizrenit	Prizren	\$ 4,580.79
Qendra Discovery	Zbuloje Prishtinën	Prishtinë	\$ 5,000.00
Organizata për Inovacione Politike "OPI"	Përmirësimi i kushteve të jetesës për banorët e vendbanimit "Qendra" në Kamenicë	Kamenicë	\$ 3,113.00
Rromani Baxt	Ngritja e pjesëmarrijes aktive të komunitetit Rom në proceset vendim marrëse	Prizren	\$ 4,022.00
Shoqata e Biznesit të Grave (WBA)	Fushata për ngritjen e vetëdijes ndaj riciklimit të mbeturinave plastike	Mitrovicë	\$ 5,000.00
TOTALI I GRANTEVE PËR AVOKIM NË NIVEL LOKAL RUNDI II			\$ 35,494.54

## Avokim në Nivel Lokal, Rundi III

Në muajin gusht, tetë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
Agro Eko	Kualiteti i ujit në shkollat e Komunës së Gjilanit	Gjilan	\$ 4,520.00
Shoqata e Kosovës për Fëmijët me Sindromin Down	Kush jam unë?	Prishtinë	\$ 5,999.00
Elena Peshkopia	Bursa për studentë	Gjilan	\$ 3,854.00
Qendra e Pavarur për Informacione Kulturore dhe Rini "Elita"	Komuna e juaj – ndikimi dhe të drejtat	Viti	\$ 4,969.00
Koalicioni për Demokraci "KOD"	Të ecim pa pengesa	Ferizaj	\$ 4,260.00
Shoqata e Kosovës e të Verbërve dhe Personave me Vështërsi në të Pamurit	Barazia për të gjithë	Prishtinë	\$ 5,910.70
Këshilli i Prindërve dhe Arsimtarëve	Arsimimi për të gjithë	Malishevë	\$ 3,218.00
Shoqata e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut	Rregulloret mbi masat e sigurisë në komunikacion për banorët e rrugës "Robert Gajdiku"	Lipjan	\$ 3,502.50
TOTALI I GRANTEVE PËR AVOKIM NË NIVEL LOKAL, RUNDI III			\$ 36,233.20

**Grantet për Aktivitete Jopartiake të Lidhura me Zgjedhjet** u janë ndarë OJQ-ve, propozimet e të cilave kanë demonstruar qasje kreative dhe aktive ndaj një sërë aktivitetesh jopartiake të lidhura me zgjedhjet për të nxitur kështu pjesëmarrjen e votuesve, ngritur vetëdijen e tyre dhe njohurit për procesin zgjedhor, si dhe promovuar dialogun dhe debatet në mes të votuesve dhe kandidatëve.

## Grantet për Aktivitete Jopartiake të Lidhura me Zgjedhjet


Në muajin tetor, tetëmbëdhjetë OJQ kanë marrë grante:

ORGANIZATA	PROJEKTI	VENDI	SHUMA
Rrjeti i OJQ-ve "Avonet"	Shfrytëzo të drejtën – voto	Ferizaj	\$ 4,822.53
Shoqata e Kosovës e të Verbërvë dhe Personave me Vështërsi në të Pamurit	Të drejtat e mia për të ditur	Prishtinë	\$ 5,955.00
Komunikimi për Zhvillim Social	Zgjedhjet në Kosovë 2007 – po ose jo	Kosovë	\$ 5,985.00
Qendra e Pavarur për Informacione Kulturore dhe Rini "Elita"	Ngritja e vetëdijes publike për votim dhe pjesëmarrje në zgjedhje	Viti	\$ 2,510.00
Syri i Vizionit	Shihemi te kutitë e votimit	Deçan Klinë Istog Pejë	\$ 8,090.00
Qendra për Trajnimë Gjinore dhe Resurse "GTRC"	Fuqizimi i kandidateve femra në zgjedhjet komunale dhe parlamentare në Kosovë	Prishtinë	\$ 5,000.00
Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim "IRD"	Njoftimi i mediave për koalicionin e OJQ-ve "Demokracia në Veprim – Zgjedhjet 2007"	Kosovë	\$ 10,000.00
Shtëpia Jonë	Zgjedhjet komunale dhe parlamentare në Kosovë: fushata dil dhe voto për komunitetin serb	Kosovë	\$ 20,089.00
Pëllumbat e Paqes	Votoj për here të parë	Mitrovicë	\$ 5,050.00
Radio Vala Rinore	Të rinjtë në zgjedhjet 2007	Prishtinë	\$ 5,000.00
Qendra për Hulumtime dhe Edukim "Rekos"	Edukimi i votuesve për procesin zgjedhor 2007	Prizren Gjakovë	\$ 6,072.00
Qendra Rinore "Rinia"	Të gjithë së bashku për votim	Kamenicë	\$ 3,500.00
Dialogu Social	Përdore votën tënde	Prishtinë	\$ 11,938.00
Spektri	Zhvillimi i komunitetit	Hani i Elezit	\$ 1,444.00
Asociacioni i Grave "Vita"	Fuqia e votës	Shtërpë	\$ 3,009.00
Me Dorë në Zemër	Misioni i shpresës	Mitrovicë	\$ 4,200.00
Shoqata e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut "YAH"	Krijimi i ambientit të përshtatshëm për zgjedhje të suksesshme në Komunën e Lipjanit	Lipjan	\$ 2,827.00
Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut "YIHR"	Fushata e bazuar në aktivizim – dil dhe voto	Kosovë	\$ 8,000.00
GRANTET PËR AKTIVITETE JOPARTIAKE TË LIDHURA ME ZGJEDHJET			\$ 113,491.53

## Procesi i ndarjes së granteve

Të gjitha projekt propozimet dhe profilet e organizatave së pari janë kontrolluar nga ekipi i granteve në ATRC për sa i përket kompletimit të dokumenteve dhe përbushjes së kritereve. Aplikacionet e pakompletuara nuk janë pranuar për shqyrtim. Përmes procesit garues të hapur dhe transparent, Komisioni për Ndaren e Granteve i ATRC-së i përbërë nga përfaqësues të IREX-it, Bordit të ATRC-së, donatorëve të tjerë, OJQ-ve dhe ekspertë të pavarur kanë vendosur për ndarjen e granteve. Anëtarët e Komisionit janë përgjedhur në bazë të paanësisë dhe njohurive të tyre ndaj sektorit të OJQ-ve dhe çështjeve të zhvillimit. Komisioni ka vlerësuar secilin projekt propozim në bazë të kritereve të përcaktuara qartë.

Zgjedhjet janë konkurs ku ne  
*punësojmë* përfaqësuesit tanë.



Një nga posterët për zgjedhje të koalicionit të OJQ-ve "Demokracia në Veprim" të përkrahur nga Programi i ATRC-së për Menaxhim Grantesh.

## PROGRAMI PËR INFORMIM



Programi i ATRC-së për Informim ka të bëj me shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, buletinit mëjor dhe ueb-faqes së ATRC-së. Diskutimet publike, shpesh të organizuara në bashkëpunim me OJQ-të e tjera, zyret qeveritare, organizatat ndërkombëtare ose ekspertë të ndryshëm, kanë për qëllim t'i informojnë qytetarët për çështje të rëndësishme që kanë ndikim në jetën e tyre, t'i informojnë OJQ-të për iniciativat që ato mund të ndërmarrin, të ofrojnë forum për këmbim përvojash dhe idesh, të informojnë publikun për aktivitetet e shoqërisë civile, të ofrojnë ekspertizë në fusha të ndryshme dhe mundësi rrjetëzimi për OJQ-të. Në vitin 2007, ATRC ka shtuar aktivitetet në teren për ti informuar kosovarët për zhvillimet politike lidhur me zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Gjatë vitit 2007, ATRC ka organizuar 90 diskutime/debate publike dhe seminare për çështje sociale, ekonomike dhe politike me interes në Kosovë:

## Diskutimet publike për Propozimin e Ahtisarit

Përfaqësues të qeverisë lokale dhe qendrore, OJQ-ve, mediave dhe sektorit të biznesit në 25 qytete të Kosovës kanë pasur mundësi të informohen, shqetësimet e tyre të dëgjohen, dhe të bëjnë pyetje për përbajtjen e propozimit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, gjatë 26 diskutimeve publike të organizuara në muajin mars nga ATRC dhe Akademia për Zhvillim Arsimor.



Takimet janë mbajtur në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Novobërdë, Kaçanik, Obiliq, Fushë Kosovë, Shtime, Klinë, Kamenicë, Graçanicë, Podujevë, Lipjan, Shtërpce, Istog, Suharekë, Rahovec, Viti, Skenderaj, Malishevë,

Zveçan, Drenas, Leposavic, Vushtrri dhe Gjilan në përpjekje për ti informuar organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët për propozimin e Marti Ahtisarit, të dërguarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për negociatat për statusin e Kosovës.

Anëtarët e Ekipit Kosovar të Unitetit të angazhuar në negociata dhe përfaqësues të zyreve të huaja diplomatike në Prishtinë kanë qenë në mesin e panelistëve.

## Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Prizren

Qytetarë të Prizrenit, përfaqësues të OJQ-ve dhe zyrtarë komunal debatuan për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prizren gjatë një diskutimi publik të organizuar nga ATRC në janar në Asamblenë Komunale të këtij qyteti.

## Termocentrali i ri "Kosova C": Zhvillim ekonomik apo ndotje e mjedisit

Përfaqësues të Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, partive politike në opozitë dhe shoqërisë civile janë takuar në ATRC për të diskutuar planet e qeverisë për ndërtimin e një termocentrali të ri në Komunën e Obiliqit. Diskutimi publik, i organizuar nga



ATRC në janar, është fokusuar në: "Termocentrali i ri "Kosova C" - zhvillim ekonomik apo ndotje e mjesdit?"

Përfaqësuesit e partive në opozitë dhe shoqërisë civile argumentuan se ky termocentral do të ketë ndikim të madh negativ në ambient.

"Niveli i ndotjes së ajrit në Komunën e Obiliqit është 400 herë mbi standardet e BE-së" Nazif Shala

shoqërisë civile kanë shqyrtuar sistemin e pensioneve në Kosovë dhe janë fokusuar në gjendjen e rëndë sociale të minatorëve, gjatë një debati publik të organizuar në muajin mars nga ATRC dhe Shoqata e Minatorëve Pensionist Invalid të Kosovës. Pjesëmarrësit konkluduan se sistemi pensional urgjentisht duhet të reformohet dhe i bën thirrje qeverisë të miratoj dhe zbatoj draft ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

## Avokimi në praktikë

Në janar, ATRC ka organizuar tryezë të rrumbulakët ndërmjet aktivistes amerikane për të drejtat e njeriut Alice Mead dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të titulluar "Avokimi në Praktikë – nga përvaja e një aktivisteje ndërkombëtare." Gjatë takimit, Mead shfaqi filmin e saj dokumentar "Kosova dhe Vdekja e Jugosllavisë" dhe diskutoi çështje të avokimit me pjesëmarrësit. "Avokimi ka të bëj me të genit i barabartë" Alice Mead

## Zhvillimi urbanistik i Prishtinës

Përfaqësues të shoqërisë civile janë takuar në ATRC në muajin mars për të diskutuar zhvillimin urbanistik të Prishtinës. Pjesëmarrësit fokusuan diskutimin në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për çështje të rëndësishme urbanistike për Prishtinën.

Ata kritikuan qeverinë lokale dhe atë qendrore për, siç thanë ata, "shkatërrimin e Prishtinës".

## Sistemi i pensioneve në Kosovë: Minatorët dhe gjendja e tyre sociale

Pensionistë, minatorë, përfaqësues të qeverisë dhe

## Transferimi i demokracisë në qeverisje

### të mirë nga perspektiva e planifikimit

ATRC dhe Habitati i OKB-së kanë organizuar tri diskutime publike në mars dhe maj në Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj gjatë së cilave ku u takuan përfaqësues të qeverive lokale, këshillave joformal, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe ekspertë për të diskutuar pjesëmarrjen e qytetarëve në kontekstin e planifikimit zhvillimor lokal.

Diskutimi është përqendruar në angazhimin e shoqërisë civile në procesin planifikues si një ndër parimet e qeverisjes së mirë dhe komponent kyç i planifikimit zhvillimor strategjik në nivel lokal.

## Diskutimet rajonale për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës

Gjatë muajit maj, përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit në pesë rajonet kryesore të Kosovës kanë pasur mundësi të informohen dhe pyesin për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, gjatë pesë diskutimeve publike të organizuara nga ATRC. Takimet rajonale në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjilan dhe Ferizaj kanë pasur për



qëllim informimin shtesë të publikut për rezultatin e zgjidhjes së statusit.

*Politikanë vendor dhe diplomatë të huaj u kanë bërë thirrje qytetarëve për paqe dhe stabilitet në kohën kur përcaktimi i statusit për të ardhmen e Kosovës ishte në fazën përfundimtare.*

Anëtarët e Ekipit Kosovar të Unitetit të angazhuar në negociata dhe përfaqësues të zyreve të huaja diplomatike në Prishtinë kanë qenë në mesin e panelistëve.

## Mjedisi në Kosovë: Ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile

Në korrik, OJQ-të u informuan për projektin e ri "Kosova e qëndrueshme: ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile mjedisore" të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC), gjatë një takimi informativ të organizuar nga ATRC dhe REC. Përfaqësuesit e REC-it në Prishtinë sqaruan objektivat e projektit në trajnimin e OJQ-ve që merren me çështje mjedisore në Kosovë për të krijuar kështu lëvizje bashkëpunimi, vitale dhe kritike, e aftëtë ndihmojë në rindërtimin socio-ekonomik dhe në dizajnimin e planeve zhvillimoreqë nuk dëmtojnë ambientin.

## Draft broshura për kushtetutën e re të Kosovës

Në muajin gusht, ATRC dhe Shoqata e Gjykatësve të Kosovës kanë organizuar dy tryesa të rrumbullakëta në Gjilan dhe Prishtinë për të shqyrtaur draft broshurën për kushtetutën e re të Kosovës me anëtarët e Shoqatës së Gjykatësve dhe përfshirjes së sug-



jerimeve të tyre në përbajtjen e broshurës, të draftuar nga Akademia për Zhvillim Arsimor (AED).

Kjo draft broshurë është konsultuar edhe me përfaqësues të OJQ-ve në gusht, gjatë një takimi në Prishtinë.

## Vizioni i Kosovës

ATRC ka organizuar në shtator një takim ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe Ashraf Ghanit, ish-ministër afgan i ekonomisë dhe financave, me qëllim të diskutimit të zhvillimeve politike, ekonomike në Kosovë dhe vizionin për të ardhmen. Diskutimi është fokusuar në përparësitë dhe mangësitë e institucioneve qeverisëse në Kosovë, çështjet shqetësuese për të ardhmen, pushteti, etj.

## Diskutimet publike për statusin final të Kosovës

Gjatë shtatorit dhe tetorit, qytetarë, përfaqësues të OJQ-ve, mediave dhe qeverisë në dymbëdhjetë qytete të Kosovës janë informuar për procesin e definimit të statusit final të Kosovës, gjatë 12 diskutimeve publike të organizuara nga ATRC dhe Zyra Britanike në Prishtinë. Diskutimet janë mbajtur në Drenas, Viti (Pozharan), Gjilan (Bresalc), Malishevë, Ferizaj (Komogllavë), Novobërdë, Gjakovë (Skivjan), Skenderaj, Podujevë, Pejë (Vitomiricë), Dragash dhe Mitrovicë, duke iu mundësuar kështu qytetarëve qasje në informata të sakta, dhe forum për të diskutuar çështjet e statusit me qeverinë dhe përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar.

Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi t'u bëjnë pyetje



liderëve të njojur kosovar dhe diplomatëve të huaj, të cilët u bën thirrje qytetarëve të jenë të durushëm dhe bashkëpunues me komunitetin ndërkombëtar.

## Zgjedhjet Komunale 2007

Në tetor dhe nëntor, qytetarët në secilin qytet të Kosovës kanë pasur mundësinë të informohen dhe participojnë përmes pyetjeve drejtuar të nominuarve për kryetar komunash të partive politike për zgjedhjet komunale, të zhvilluara më 17 nëntor. ATRC, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese dhe Institutit për Studime të Avancuara kanë organizuar 27 debate publike në Kaçanik, Viti, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Drenas, Malishevë, Rahovec, Dragash, Suharekë, Prizren, Gjakovë, Deçan, Pejë, Istog, Klinë, Skenderaj, Shtërpce, Shtime, Lipjan, Mitrovicë, Vushtrri dhe Prishtinë. Kjo iniciativë ka pasur për qëllim të kontribuoj në edukimin e votuesve për çështje të politikave gjatë debateve zgjedhore informative për ti shtyrë partitë politike për ide dhe plane që realisht i trajtojnë problemet sociale dhe ekonomike të Kosovës. Debatet janë transmetuar në kanalin televiziv publik të Kosovës RTK dhe në njëzet e shtatë radio dhe televizione lokale në tërë vendin.

## ‘Takoni Donatorët’

Prezantimet e donatorëve synojnë njoftimin e OJQ-ve për mundësi financimi dhe krijimin e lidhjeve të donatorëve me OJQ-të që kanë interesa të ngjashme.

## Prezantimet e donatorëve:

### Swiss Kontakt

Në prill, Claudia Ulrike Gminder përfaqësuese e Swiss Kontaktit ka informuar OJQ-të e Kosovës për programet e këtij donatori gjatë një takimi të organizuar nga ATRC. Takimi është fokusuar në projektin për gratë në biznes të Swiss Kontaktit, objektivat dhe priorititetet e financimit, dhe procedurat e aplikimit.

### Qendra Ndërkombëtare Olof Palme

Në maj, koordinatori i Qendrës Ndërkombëtare

Olof Palme në Prishtinë, Levent Biçaku, informoi përfaqësues të OJQ-ve lokale për programet e Qendrës Palme dhe mundësitë e financimit gjatë dy prezantimeve të organizuara nga ATRC në Prishtinë dhe pjesën veriore të Mitrovicës. Biçaku veçoi objektivat dhe priorititetet e financimit, procedurat e aplikimit, sikurse edhe fondet në dispozicion për Kosovën.

## Fondi i Vëllezërve Rockefeller

ATRC ka organizuar dy takime ndërmjet OJQ-ve lokale dhe përfaqësuesit të Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF) për Ballkanin Perëndimor, Haki Abazi. Takimet, e zhvilluara në maj në Prishtinë dhe pjesën veriore të Mitrovicës, kanë pasur për qëllim informimin e OJQ-ve lokale për grant programet e RBF-së të cilat fokusohen në katër fusha: praktikat demokratike, zhvillimi i qëndrueshëm, paqja dhe siguria, dhe avancimi i njerëzve.

## Programi Kosovar për Shoqëri Civile i ATRC-së dhe IREX-it

Në korrik, përfaqësues të ATRC-së dhe IREX-it zhvilluan dy takime informative në Graçanicë dhe pjesën veriore të Mitrovicës për ti informuar OJQ-të e minoritetit serb për mundësi financimi përmes runit të gjashtë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim të Programit Kosovar për Shoqëri Civile, finansuar nga USAID. Përfaqësuesit e ATRC-së dhe IREX-it prezantuan fushat e financimit në kuadër të këtij rundi, procedurat e aplikimit, kriteret e seleksionimit, procesin e shqyrtimit, afatin kohor për aplikim, etj.

*Diskutimet publike të ATRC-së kanë mbledhur më shumë se 16,300 qytetarë, përfaqësues të OJQ-ve, vendim-marrës dhe ekspertë gjatë vitit 2007. Kur konsideron të nevojshme, ATRC fton mediat me qëllim që informatat të arrijnë tek publiku i gjërë. Në vitin 2007, 130 artikuj janë publikuar në gazetat e përditshme të Kosovës dhe 152 storie janë transmetuar në mediat elektronike për diskutimet publike të organizuara nga ATRC. Artikujt e gazetave për ATRC-në ndodhen në [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org) (kliko ATRC në Media)*

## Buletini “Avokuesi”

ATRC ka vazhduar publikimin e buletinit elektronik mujor “Avokuesi” i cili përmban udhëzime dhe informata praktike të cilat OJQ-të dhe grupet e tjera të interesuara mund t'i përdorin gjatë punës së tyre. “Avokuesi” u është dërguar në mënyrë elektronike qindra OJQ-ve, mediave, institucioneve qeveritare, agjencive ndërkombëtare dhe përkrahësve potencial në dhe jashtë Kosovës. “Avokuesi” publikohet në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe dhe ndodhet në ueb-faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

## Broshura

Në vitin 2007, ATRC ka publikuar broshurë të re me të cilën ofrohen informata të shkurtra dhe gjithëpërfsirëse për profilin, aktivitetet, shërbimet dhe resurset e kësaj organizate. Broshura mund të shkarkohen në ueb-faqen [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

## Ueb-faqja: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

ATRC ka ridizajnuar ueb-faqen duke e bërë atë më të përshtatshme për shfrytëzuesit në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në vitin 2007, ueb-faqja është vizituar 13.729 herë.

## Biblioteka

Biblioteka e ATRC-së posedon më shumë se 1.060 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, lidership, të drejtat e njeriut, mjedis, vetëdijesim gjinor, etj. Biblioteka është e hapur për OJQ lokale dhe ndërkombëtare, studentë, gazetarë, punonjës në qeveri dhe qytetarë të interesuar.



## PROGRAMI PËR AVOKIM



Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC përkrah organizatat që incojnë ndryshime në komunitetin e tyre në nivel lokal dhe kombëtar përmes ofrimit të trajnimeve dhe ndarjes së granteve. Programi për Avokim po ashtu siguron forum për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizëm në nivel lokal. Në vitin 2007, ATRC është përfshirë në këto iniciativa:

### Zhvillimi i shoqërisë civile

ATRC ka koordinuar Grupin për Zhvillim të Shoqërisë Civile i përbërë nga tetëmbëdhjetë anëtarë, përfaqësues të OJQ-ve lokale dhe institucioneve qeveritare të përfshirë në çështje të sektorit të shoqërisë civile. Grupi, i cili synon vendosjen e një sistemi ligjor për këtë sektor në Kosovë, ka fokusuar aktivitetet avokuese në legjislacionin për OJQ-të, krimin e një ambienti të brendshëm rregullativ brenda sektorit të shoqërisë civile dhe financimin publik për këtë sektor. Grupi ka aprovuar rregulloren e punës dhe ka zgjedhur trupin udhëheqës.

Ai ka përgatitur disa rekomandime për draft ligjin për Lirinë e Asocimit të OJQ-ve, dhe ka avokuar nëpërmjet takimeve me kryesuesit e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës për ti përfshirë këto rekomandime në draft ligj para se ai të miratohet.

Grupet parlamentare janë pajtuar me rekomandimet dhe janë zotuar se do ti përfshijnë ato në draft ligjin final, i cili pritet të miratohet në vitin 2008.

Rekomandimet u janë dërguar krye parlamentarit të Kosovës dhe përfaqësuesve të partive politike. Ato kanë të bëjnë më paragrafët lidhur me *regjistrimin e domosdoshëm, ri-regjistrimin, organizatat e përbëra/rrjetëzimi, OJQ-të dhe mikro-kreditë*, etj.

### Luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore

Në shtator, ATRC dhe Partneriteti kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i implementuan nga Shërbimi Katolik i Ndihmave kanë organizuar takime rajonale në gjashtë qytetet më të mëdha të Kosovës për të adresuar çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo iniciativë mblohti së bashku OJQ-të lokale dhe ekspertë të sferës publike dhe shoqërisë civile për

të mësuar më gjërësisht dhe komentuar për zbatimin e Planit Kosovar të Veprimit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Takimet me titull "Rëndësia e Shoqërisë Civile në Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore" janë organizuar posaçërisht për organizatat e shoqërisë civile në rajonin e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajit dhe Gjilanit, ku Qendra Juridike e Kosovës prezantoi raportin e monitorimit të Planit Kosovar të Veprimit. Takimet kanë qenë diskutime të hapura për të gjithë pjesëmarrësit të cilët kanë rekomanduar që: institucionet qeveritare dhe OJQ-të të bashkëpunojnë ngushtë në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, prokuroria dhe gjykatat të përfshihen në implementimin e Planit Kosovar të Veprimit, mediat të raportojnë më shumë për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, etj.

### Parandalimi i dhunës familjare

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes publike për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën familjare, ATRC në bashkëpunim me Iniciativën për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Grave ka shpallur në tetor konkursin për storien më të mirë gazetareske për temat e lartpërmendura - të publikuar ose transmetuar në mediat e Kosovës gjatë periudhës tetor - dhjetor 2007.

Fituesit, gazetaret e Ingopress dhe Radio Kosovës - Antigona Uka dhe Hyrë Tejeci, janë shpallur gjatë një ceremonie në ATRC në dhjetor të organizuar me qëllim që të njihet publikisht kontributi i gazetarëve të cilët me storiet e tyre kanë trajtuar dhunën ndaj grave/dhunën familjare.



## ANTARËT E BORDIT TË ATRC-së

**Ilaz Ramajli**  
Avokat; Ramajli dhe Partnerët

**Sejdi Osmani**  
Drejtëor; RIINVEST

**Petrit Selimi**  
Drejtëor ekzekutiv; KUMT Consulting

**Anton Berishaj**  
Profesor; Universiteti i Prishtinës  
(deri në dhjetor 2007)

**Mirlina Bunjaku**  
Drejtoreshë ekzekutive; Fondi për Zhvillim  
të Komunitetit

**Astrit Istrefi**  
Projekt koordinator; Saferworld

## STAFI I ATRC-së

Drejtoreshë ekzekutive  
**Rreze Duli**  
rreze@advocacy-center.org

Menaxher finansiar dhe administrativ  
**Gani Asllani**  
gani@advocacy-center.org

Menaxhere e trajnimeve dhe konsulencave  
**Donika Podrimja-Salihu**  
donika@advocacy-center.org

Trajnere dhe konsultante  
**Afërdita Surroi**  
aferdita@advocacy-center.org

Trajner dhe konsulant  
**Kushtrim Islami**  
kushtrim@advocacy-center.org

Trajnere dhe konsultante  
**Nora Susuri**  
nora@advocacy-center.org

Menaxher i granteve  
**Kushtrim Kaloshi**  
kushtrimk@advocacy-center.org

Përgjegjës për grante  
**Xhafer Ahmeti**  
xhafer@advocacy-center.org

Përgjegjëse për grante  
**Natyra Zhjeqi**  
natyra@advocacy-center.org

Menaxhere financiare e granteve  
**Safeta Xhekoviq**  
safeta@advocacy-center.org

Menaxhere për komunikim  
**Arjeta Doroci**  
arjeta@advocacy-center.org

IT Menaxher  
**Arsim Kosumi**  
arsim@advocacy-center.org

Ekipi i Projektit për Monitorimin e të Kthyerve  
**Emine Emini**  
emine@advocacy-center.org

**Gëzim Kunoviku**  
gëzim@advocacy-center.org

**Hysen Hamzaj**  
hysen@advocacy-center.org

**Zaid Kulinxha**  
zaid@advocacy-center.org

## KONTAKT INFORMATAT

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim  
Tel/faks: +381 38 244 810  
info@advocacy-center.org  
www.advocacy-center.org

## Lokacioni i ATRC-së:

Zyret e ATRC-së janë afér qendrës së Prishtinës në  
këtë adresë: Rr. Agim Ramadani, Nr. 15, katë i 2-të,  
Prishtinë, Kosovë



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



Publikimi i këtij raporti është mundësuar finanziarisht me përkrahjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Bordit për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX), në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk pasqyron detyrimisht qëndrimet e USAID-së ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

# SADRŽAJ

<b>Pismo Izvršnog direktora .....</b>	<b>2</b>
<b>Uvod .....</b>	<b>3</b>
O ATRC-u .....	3
Podržavaoci .....	4
Partneri .....	4
O ovome izveštaju .....	4
<b>Program obuke, konsultacija i izgradnje kapaciteta .....</b>	<b>5</b>
Radionice .....	6
Prilagođeni treninzi .....	8
Treninzi rešavanja socijalnih konflikata na nekoliko nivoa .....	7
Konsultacije .....	8
<b>Program davanja grantova .....</b>	<b>9</b>
Grantovi za Partnerstvo i Umrežavanje .....	10
Grantovi za Zastupanje Sirokih Slojeva .....	12
Grantovi za Inicijative u Vezi Nestranačkih Izbornih Aktivnosti .....	14
<b>Informativni program .....</b>	<b>16</b>
Javni dijalozi .....	17
Bilten i brošura .....	21
Web stranica .....	21
Biblioteka .....	21
<b>Program zastupanja .....</b>	<b>22</b>
<b>Članovi odbora .....</b>	<b>24</b>
<b>Osoblje i kontakt informacije .....</b>	<b>24</b>

# PISMO IZVRŠNOG DIREKTORA

Prošla godina bila je jedna od najizazovnijih godina u istoriji Kosova. Bila je to godina kada su završeni pregovori o statusu Kosova, kojima je posredovala međunarodna zajednica. Bila je to godina izbora kada su održani i parlamentarni i lokalni izbori. Što je još važnije, bila je to godina kada je Ahtisarijev sveobuhvatni predlog za Kosovo usvojen od strane Parlamenta Kosova i kada je počelo planiranje predaje ovlašćenja sa UNMIK-a na Kosovo.

Svi ovi događaji bili su važni za civilno društvo Kosova, koje je povremeno nadvladano dinamikom političkog okruženja. Civilno društvo se našlo razapeto između svoje uloge svakodnevnog čuvara i potrebe da iskaže svoje mišljenje u najvažnijim odlukama koje su pripremane za budućnost Kosova.

Uloga ATRC-a u 2007 godini bila je presudna u obezbeđivanju da civilno društvo i građani Kosova dobiju glas u svim ovim odlukama. Osoblje ATRC-a radilo je neprekidno kako bi udovoljilo svim zahtevima NVO-a i građana da javno iznesu mišljenje i imaju uticaja u velikim odlukama.

Pored toga, tokom 2007 godine ATRC je obezbedio resurse u smislu grantova i treninga 215 NVO-a kako bi unapredio njihovu delotvornost u zastupanju pitanja kojima se bave. ATRC nastavlja da uživa poverenje NVO-a i građana Kosova kao sredstvo prenošenja njihovih stavova donosiocima odluka.

Srdačan pozdrav,  
**Rreze Duli**  
**Izvršni direktor ATRC-a**



## UVOD

### Misija

Centar za obuku i resurse u zastupanju (ATRC) je kosovska neprofitabilna organizacija koja radi na unapređenju učešća građanskog i civilnog društva u procesu donošenja odluka, što je preduslov za demokratsko društvo i regionalnu stabilnost.

ATRC radi sa predstavnicima nevladinih organizacija (NVO), građanskih inicijativa, javne administracije, političkih institucija i medija bez obzira na versku i političku pripadnost, etnicitet, starost, pol, sposobnosti i seksualnu orientaciju.

ATRC realizuje svoje ciljeve putem zastupanja, obuke, razmene informacija i umrežavanja na Kosovu i šire.

### O ATRC-u

